

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS
ZYRA E VLERESIMEVE DHE STATISTIKAVE
440 North Broad Street
Philadelphia, PA 19130

Michael Schlesinger
Kryetar

Tel: 215-400-4250
Faks: 215-400-4251

21 Shtator 2010

PER: Prindërit e të gjithë nxënësve të klasave të 11^{-ta} dhe 12^{-ta}
Nxënësit e klasave 11 dhe 12

SUBJEKTI: Ç' duhet pasur parasysh që Emri dhe Adresa e fëmijës suaj **TE MOS** u lëshohet rekrutëve ushtarakë

Shteti i Pensilvanisë dhe qeveria Federale¹ kërkon që, Drejtorja Arsimore t'u lëshojë automatikisht rekrutëve ushtarakë të dhëna mbi fëmijën tuaj si emrin, seksin, adresën, numrin e telefonit, dhe emrin e shkollës nëse, prindërit **NUK** firmosin formularin, ku ata refuzojnë lëshimin e emrit të fëmijës së tyre rekrutëve ushtarakë. Qëllimi i kësaj letre është t'ju njoftojë juve (dhe fëmijën tuaj, nëse është 18 vjeç e lart) se si të veproni në këtë rast, pra që të dhënat personale mbi fëmijën tuaj të mos u lëshohen rekrutëve ushtarakë. Nëse, ju NUK dëshironi që emri i fëmijës suaj t'u lëshohet rekrutëve ushtarakë, thjesht veproni si më poshtë:

- **Plotësoni informacionin e mëposhtëm në këtë formular.**
- **Fëmija juaj duhet të kthejë formularin e plotësuar mësuesit kujdestar të klasës (*advisor*), jo më vonë se 22 Tetor 2010.**
- **Shënim: Nxënësit 18 vjeç e lart mund të firmosin formularin vetë.**

Mësuesi këshilltar e përcjellë formularin tuaj nëpunësve të personelit, të cilët bëjnë shënimin në sistemin kompjuterik të Drejtorisë që, emri i fëmijës suaj dhe çdo informacion tjetër nuk do t'u lëshohet rekrutëve ushtarakë. Ju gjithashtu mund të bëni daunload kopje të kësaj letre (dhe versionin e përkthyer) duke shkuar në faqen e websaitit të Drejtorisë Arsimore (<http://www.phila.k12.pa.us>), dhe klikoni në seksionin "STUDENTS".

Për çdo pyetje apo problem, ju lutemi takoni mësuesin e klasës ose atë këshilltar të fëmijës suaj.

¹Ky tekst jep më shumë detaje rreth këtyre ligjeve. Në 27 Qershor 1991, Shteti i Pensilvanisë dekretoi një ligj, sipas të cilit detyron Drejtoritë Arsimore t'u japë zyrave të rekrutimit të forcave të armatosura informacionin mbi listat e nxënësve të Shkollave të Mesme, njëllor si shkollat e larta dhe ato profesionale. Legjislacioni (Dekreti 10) më tej parashtron se "nxënësit duhet të njoftohen mbi kërkesat e këtij dekreti dhe t'u jepet afat 21 ditë të kthejnë përgjigje me shkrim, nëse do të kërkojnë të përjashtohen nga kjo listë". Për më tepër, sipas dekretit "Asnjë fëmijë të mos mbetet mbrapa" të vitit 2001, prindërit duhet të marrin njoftim rreth këtyre kërkesave dhe mundësisë së zgjedhjes së përjashtimit të fëmijës tyre nga lista e nxënësve, që u dërgohet rekrutëve të ushtrisë.)

FORMULARI I PERJASHTIMIT TE NXENESIT NGA LISTA E REKRUTIMIT

Unë e kuptoj që, Drejtorja Arsimore e Filadelfias duhet t'u japë forcave ushtarake, sipas kërkesës së këtyre të fundit, listat e nxënësve për qëllim rekrutimi. Unë, i nënshkruari i mëposhtëm, nuk dëshiroj që, emri i fëmijës tim t'u dërgohet rekrutëve të forcave të ushtrisë. **Nxënësit mund ta firmosin dhe dorëzojnë vetë formularin e përjashtimit nga ushtria.**

EMRI I NXENESIT (*Student's name*): (me gërma të mëdha dhe qartë) _____

FIRMA E PRINDIT (*Parent's signature*): _____

SHKOLLA (*School*): _____ KLASA (*Grade*): _____ Nr. I KLASES KUJDESTARI (*Advisory #*): _____

SCHOOLS: COMPLETE DATA ENTRY NO LATER THAN OCTOBER 22, 2010